



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 7839 prot.

Himarë, më 16.12. 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. 44, Datë 16/12/2024

**“PËR DHËNIEN E MIRATIMIT NË PARIM PËR FILLIMIN E BASHKËPUNIMIT
ME SHOQËRINË “EGEU STONE”SH.P.K”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr.44/2025 “Kodi i procedurave administrative”, në nenin 22, nenin 23, të ligjit Nr.10 304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit në parim për fillimin e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Shoqërisë “EGEU STONE”sh.p.k.
2. Dhënie e miratimit për Kryetarin e Bashkisë Himarë z. Vangjel Tavo, të përfaqësojë Bashkinë Himarë, në lidhjen e marrëveshjeve paraprake dhe përfundimtare të bashkëpunimit me Shoqërinë “EGEU STONE”sh.p.k., në fushën e nxjerrjes dhe shfrytëzimit të mineralit në interes të Bashkisë Himarë, sipas kushteve të lejes dhe kushteve të përcaktuara në këto marrëveshje.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI

Vagjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 7839/2 prot.

Himarë, më 16.12.2024

RELACION:

**MBI PROJEKT VENDIMIN "PËR DHËNIEN E MIRATIMIT NË PARIM PËR
FILLIMIN E BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRINË "EGEU STONE" SH.P.K"**

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi që po ju paraqesim vjen pasi kemi marrë dhe shqyrtuar një kërkesë nga Shoqëria "EGEU STONE", për shprehje interesi për të zgjeruar aktivitetin e saj në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të gurit gelqeror pranë dhe në shërbim të Bashkisë Himarë.

Shoqëria ka kryer kërkimet dhe studimet e saj në territorin e bashkisë Himarë ku dhe ka zbuluar një zonë pranë kodrinës midis Dhërmiut dhe Iliasit sipas hartës bashkëlidhur këtij relacioni. Pas verifikimeve në terren është vërejtur se kjo përbën një zonë e cila nuk ndikon në mjedis dhe ndodhet larg rrugës kryesore pra rrjedhimisht nuk ka impakt mjedisor pranë rrugës kryesore dhe fshatrave përreth.

Përshkrimi i marrëveshjes dhe qëllimi i saj:

Marrëveshja e propozuar ka si objekt bashkëpunimin midis Bashkisë Himarë dhe shoqërisë "EGEU STONE" sh.p.k., për shfrytëzimin e një zone minerare që ndodhet në juridiksionin territorial të Bashkisë Himarë. Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje është nxjerrja dhe shfrytëzimi i materialeve minerale, të cilat do të përdoren për projekte infrastrukturore publike lokale që do të realizohen nga Bashkia Himarë.

Përdorimi i materialeve dhe projektet infrastrukturore:

Materiali i nxjerrë nga miniera do të përdoret për ndihmën në zhvillimin e projekteve infrastrukturore të Bashkisë Himarë. Disa nga këto projekte janë të rëndësishme për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e infrastrukturës së zonës. Këtu mund të përmendim:

1. **Rehabilitimi i trotuareve dhe infrastrukturës së përgjithshme:** Përdorimi i materialeve të nxjerra do të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të trotuareve dhe infrastrukturës rrugore në qytet dhe fshatra.
2. **Ndërtimi i rrugëve për në varrezat e qytetit dhe fshatrave:** Këto rrugë janë një projekt i rëndësishëm për sigurinë dhe lehtësimin e aksesit të banorëve dhe vizitorëve, veçanërisht në periudhën e ceremonive dhe aktiviteteve lokale.
3. **Ndërtimi i shesheve:** Sipas planit të investimeve të Bashkisë Himarë, një pjesë e materialeve do të përdoret për ndërtimin e sheshit, një projekt që do të rrisë cilësinë e jetesës dhe do të krijojë mundësi për aktivitete publike dhe sociale.
4. **Ndërtimi i rrugëve të lagjeve dhe rrugëve ndërlidhëse të fshatrave:** Në Bashkinë Himarë, një nga prioritetet kryesore për zhvillimin e infrastrukturës është ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve brenda lagjeve dhe lidhja e këtyre lagjeve me rrugët nderlidhëse të fshatit. Këto projekte janë thelbësore për përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët, lehtësimin e lëvizjes dhe zhvillimin e ekonomisë lokale, si dhe për rritjen e aksesit për shërbime dhe aktivitete të ndryshme publike. Përsa i përket ndikimit në komunitet;

Rrugët e lagjeve janë arterie të rëndësishme që lidhin zonat e banuara me qendrat administrative, tregtare dhe shërbyese. Ndërtimi i këtyre rrugëve do të ketë disa ndikime pozitive për komunitetin dhe zhvillimin e përgjithshëm të zonës:

- Përmirësimi i Kushteve të Jetës: Banorët e fshatrave dhe lagjeve do të kenë mundësi të përfitojnë nga kushte më të mira transporti dhe akses në shërbime, si ujë, energji dhe shëndetësi.
- Siguria dhe Komoditeti: Rrugët e lagjeve mundësojnë një lëvizje më të sigurt dhe të lehtë për banorët, veçanërisht për fëmijët, të moshuarit dhe ata me aftësi të kufizuara.
- Zhvillimi i Aktivitetit Ekonomik: Ndërtimi i infrastrukturës rrugore do të stimulojë aktivitetet tregtare dhe turistike, duke i mundësuar banorëve të transportojnë më lehtë produktet bujqësore dhe artizanale, si dhe tërheqjen e turistëve që vizitojnë Himarën.

Përfitimet për Bashkinë Himarë:

1. **Përfitim ekonomik:** Përdorimi i materialeve të nxjerra për projektet infrastrukturore të Bashkisë Himarë do të kontribuojnë në uljen e kostove të këtyre projekteve, duke siguruar burime materiale pa pasur nevojë të blihen nga jashtë.

2. **Përmirësimi i infrastrukturës:** Përdorimi i materialeve minerale për rehabilitimin e infrastrukturës rrugore dhe ndërtimin e objekteve publike do të ketë një ndikim pozitiv në cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe zhvillimin e turizmit në zonë.

3. **Në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë "EGEU STONE" sh.p.k.:** për shfrytëzimin e materialeve minerale, një pjesë e materialeve të nxjerra do të përdoren për ndërtimin e varrezave, shesheve, rrugëve të lagjeve dhe rrugëve nderlidhëse. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për Bashkinë Himarë, pasi do të sigurohet një furnizim me materiale ndërtimi cilësore dhe të qëndrueshme, pa pasur nevojë për shpenzime shtesë për mundësimin e tyre. Përdorimi i materialeve minerale për ndërtimin e këtyre veprave do të:
 - **Ulë Kostot e Ndërtimit:** Përdorimi i materialeve lokale mund të ulë ndjeshëm shpenzimet për ndërtimin e veprave, duke mundësuar alokimin e fondeve të tjera për projekte të tjera infrastrukturore.
 - **Sigurim të Cilësisë së Ndërtimit:** Materialet minerale të prodhuara nga një minierë e licencuar dhe e monitoruar do të garantojnë që ndërtimi i veprave të jetë me cilësi të lartë dhe të qëndrueshëm gjatë kohës.

Roli i shoqërisë "EGEU STONE" shpk dhe Angazhimi i Bashkisë Himarë:

1. **Shoqëria "EGEU STONE" shpk** do të marrë përsipër nxjerrjen dhe shfrytëzimin e mineralit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe do të veprojë sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen finale. Kjo do të realizohet pas ndjekjes së procedurave ligjore dhe marrjes së lejeve përkatëse për nxjerrjen e mineralit nga organet përgjegjëse.

2. **Bashkia Himarë** do të sigurojë se ky bashkëpunim është në përputhje me interesat dhe nevojat e saj publike, duke monitoruar nga afër procesin e shfrytëzimit të materialeve dhe përdorimin e materialeve për projektet infrastrukturore. Gjithashtu, Bashkia do të sigurojë që ky proces të jetë në përputhje me të gjitha rregulloret dhe politikat mjedisore në fuqi.

Procedura Ligjore dhe Detyrimet e Palëve:

Para se të realizohet marrëveshja përfundimtare, do të ndiqen të gjitha procedurat ligjore të nevojshme për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e materialeve minerale. Kjo përfshin:

1. **Marrjen e lejeve përkatëse:** Shoqëria "EGEU STONE" shpk duhet të marrë lejet për shfrytëzimin e zonës minerare nga autoritetet kompetente.
2. **Kontrollet dhe monitorimi:** Si pjesë e marrëveshjes, do të sigurohet që shfrytëzimi i zonës minerare të bëhet në përputhje me standardet mjedisore dhe shëndetësore të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar.

Përfundim:

Marrëveshja për shfrytëzimin e zonës minerare midis Bashkisë Himarë dhe shoqërisë “EGEU STONE” shpk paraqet një mundësi për zhvillimin e infrastrukturës lokale, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe uljen e kostove për projekte të ndryshme publike.


Ky bashkëpunim është i domosdoshëm për realizimin e projekteve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës, duke siguruar gjithashtu përdorimin efikas të resurseve minerale për interesin e komunitetit.

Këshilli Bashkiak i Himarës është i ftuar të shqyrtojë dhe të aprovojë këtë projekt vendim për të mundësuar implementimin e projekteve të mëdha infrastrukturore që do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës.

Bashkëlidhur këtij relacioni:

1. Kopje e hartës topografike me konturet e zonës minerare.
2. Kopje e kërkesës së shoqërisë “EGEU STONE” sh.p.k.

KRYETAR
Vangjel Tavo





HARTA TOPOGRAFIKE ME KONTURET E ZONES MINERARE KERKUAR PER SHFRYTEZIM OBJEKTI "ILIAS", HIMARE, VLORE

SHK; 1:25000

4449000

4448000

4447000

4446000

4445000


4449000

4448000

4447000

4446000

4445000



**Koordinatat e zones minerare
kerkuar per shfrytezim**

Nr	Y	X
1	4385951	4447048
2	4385190	4447700
3	4385390	4447700
4	4385521	4447594
5	4385580	4447646
6	4385532	4447724
7	4385657	4447813
8	4385986	4447613
9	4386336	4447141

Sip = 0.37 km²

4384000

4385000

4386000

4387000

4388000



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË
SEKTORI I SEKRETARISË DHE I ARKIVIT
ZYRA E SEKRETARISË

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: Shqipëria - Gjeografia dhe Historia - Shkup

Nr. prot. Data

Shkurtimi i lëndës: Kërkesë për përfundim të ligës shqiptare

Për trajtim nga:	<u> </u>
Struktura të tjera të	<u> </u>
Me porosi:	<u> </u>

Afati: Normal (7 ditë) / Prioritet (3 ditë) / Urgjent (brenda ditës) / Pa afat / Për dijani / Tjetër: ditë /

Data 17.10.2024 Nr. prot. 6073

Marrë në dorëzim më: 18.10.2024

KRYETARI I BASHKISË: Vangjel Tavo

Nënshkrimi: [Signature]

I kalon për trajtim drejtorisë: Kryedari

Data: 18.10.2024

Me porosi:

Nënshkrimi:

I kalon për trajtim sektorit: Drejtorisë së hyqësive

Data: 18.10.2024

Me porosinë:


Nënshkrimi:

Marrë në dorëzim:

Trajtimi i materialit përfunduar me: Specialisti

Trajtimi i materialit përfunduar me: Përgjegjësi i sektorit

Trajtimi i materialit përfunduar me: Drejtori



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "EGEU STONE" SHPK

Adresa: Tirane MEZEZ Kashar, Mezes, Rruga Pavaresia, ne ane te CASA ITALIA,
zona kadastrale 2679, nr i pasurise 124/131-N15
Mobile: +355 69 20 78 514

Nr _____ Prot. _____

Data: ____ / ____ / 2024

Lënda: *Kërkesë për shprehje interesi dhe pajisje me leje minerare, për qëllime publike sipas neni 22 dhe 23 te Ligjit nr 10304 date 15.07.2010 "Per Sektorin Minerare ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, objekti "Ilias", bashkia Himarë, qarku Vlorë.*

BASHKISË HIMARË

~~HIMARË, ALBANIA~~

Të nderuar,

Shoqëria "Egeu Stone" sh.p.k , është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT: L63916002I, dhe administrator z. Gazim Bregu si aktivitet të sajën ka, Nxjerrja, perpunimi, tregtimi i gurëve dekorative, materialeve inerte etj. Ndërtime civile, industrial, turistike, etj...

Shoqëria "Egeu Stone" shpk, kërkon dhe shpreh interes për të zgjeruar aktivitetin e saj në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të gurit gëlqeror pranë bashkisë suaj (bashkisë Himarë).

Shoqeria jonë ka kryer kërkimet dhe studimet e saj në territorin e bashkisë Himarë ku dhe ka zbuluar një zonë pranë kodrinës midis Dhërmiut dhe Ilias. Një zonë e cila nuk ndikon në mjedis dhe larg rrugës kryesore pra rrjedhimisht nuk ka impakt mjedisor pranë rrugës dhe fshatrave përreth. Kjo zonë ndodhet në koordinatat e poshtë shënuara.

Zona e kerkuar për leje minerare shfrytëzimi bënë pjesë në hartën topografike me nomenklaturë K-34-136-C-b, të shkallës 1:25000 me këto koordinata:

Koordinatat e zonës minerare,

Koordinatat e zonës minerare kërkuar për shfrytëzim		
Nr	Y	X
1	4385951	4447048
2	4385190	4447700
3	4385390	4447700
4	4385521	4447594
5	4385580	4447646
6	4385532	4447724
7	4385657	4447813
8	4385986	4447613
9	4386336	4447141
Sip = 0.37 km²		

Me qënë se, kjo zonë e kërkuar nuk ndodhet në planet ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës i tregon si zona minerare ku subjektet aplikojnë për tu përcësuar me leje minerare, do të shprehim interesin tonë për të krijuar një marrëveshje bashkëpunimi ku me pas ne si shoqëri të aplikojm për tu pajisur me leje minerare dhe leje mjedisore.

Duam tju sqarojmë së kjo zonë e kërkuar sipas kërkimeve dhe updatimeve në faqen e e-planifikimi na rezulton se është tokë shtet territor i bashkisë Himarë, njësia Strukturore VR.N. 1069, sistemi Natyrë ku përcaktohet dhe kategoria,

N.5_Zona me shpatet e larta (rrafshnaltat/luginat e thella/Shkëmbinjtë bregdetarë).

Më poshtë ju paraqesim dhe foto e marrë nga faqja zyrtare e e-planifikimi nga AKPT (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit).

Kjo informacion i marrë gjendet lehtësisht i aksesueshëm ku dhe kjo zonë është e miratuar me miratimin e planit të bashkisë Himarë, ku është miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 2 datë 16.10.2017 miratimi i „Planit të Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Himarë“, Këshilli Kombëtar i Territorit.

Njësisia Strukturore: VR.N.1069

Emri i	Himari
Njësia	VR.N.1069
Sistemi	N_Natyror
Kategori	N_Natyrë
Kategori 1	
Kategori 2	
Kategori 3	
Kategori 4	
Lartësia në Kete	<1=0
Lartësia në Metra	<1=0
FDV	JC
Intesitet	<1=0
KB-HT	<1=0 %
KB-HF	0%
KB-HP	0%
Udhëzime Uj dhe	
Shprehja e vlerës	2793.00
Nenkatëgори 1	N.5_Zona me shpatet e larta (nërshnjatja luginat e thella (Ghkëmbinjtë bregdetarë)
Nenkatëgори 2	
Nenkatëgори 3	
Nenkatëgори 4	
Parcela mjedise	K1=0 m2
Shprehja e vlerës	
Ferçorimi të Ndësuara	
Konstatimi i tyre	
Prezantimi	mbare mbare




Foto të marrë nga webi, mbi gjendjen e parcelës

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.T.

Z. EDI RASHA

KRYETARI I BASHKISË

Z. HANIAN GJINJERI

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Z. FOTO PARDHIVI

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 122 Datë 30.08.2017

Kryetari i Bashkisë

Z. JORGO GORO

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË HIMARË
RREGULLORE E PLANIT

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.2, Datë 16.10.2017

DPKZHT: GENTIAN STRATOBËRDHA

STUDIO KONSULENTE "DEA STUDIO" Nr.Liq. 4919/4 dhe "THYMIO PAPA YANNIS &
ASSOCIATES INC"

deastudio
"Dokumentimi dhe Planifikimi Urban dhe Territorial"
"Konsultime dhe Projektim"

Kjo zonë ka statusin VR.N.1069, FID, 1067, OBJECT-ID 1976, NJAP VR, ID 1084, ZONA VR.N, NJËSI STRUKTUR VR.N.1069, SIP HA 2793.06, SISTEMI N, KATEGORIA BAZË N.5, PERDORIMI I LEJUAR -, PERDORIMI I NDALUAR -, TIPOLOGJIA ZN1, NDERHYRJA KONSERVIM NATYROR, PDV JO.

NO. STRUKTUR	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	NO. IDENTIFIKIM	
1	1069	1067	1976	1084	1069	N	5	-	-	ZN1	KONSERVIM NATYROR	NO									
2	1069	1067	1976	1084	1069	N	5	-	-	ZN1	KONSERVIM NATYROR	NO									
3	1069	1067	1976	1084	1069	N	5	-	-	ZN1	KONSERVIM NATYROR	NO									

Sqarimet sipas përcaktimeve në tabelen e miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë.

Shoqëria jonë më së përparë dhe do të angazhohet për të kryer dhe punime infrastrukturore në ndihmë të komunitetit që ndodhet Brenda territorit të bashkisë Himarë.

~~Siç dhe shpjeguar më sipër dhe me qenë se, kjo zonë e kërkuar nuk ndodhet në planin ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i tenderon si zona minerare, shpresojmë në marrjen në konsideratë të kërkesës sonë.~~

Bashkëlidhur do të gjeni hartën topografike me koordinatat e kërkuara.

Më respekt,

Për "EGEU STONE " sh.p.k.

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË
GAZIM BREGU

Gazim Bregu




**ARTA TOPOGRAFIKE ME KONTURET E ZONES
MINERARE KERKUAR PER SHFRYTEZIM
OBJEKTI "ILIAS", HIMARE, VLORE**

SHK; 1:25000

4449000

4448000



4449000

4448000

4447000

4446000

4445000

Koordinatat e zones minerare kerkuar per shfrytezim		
Nr	Y	X
1	4385951	4447048
2	4385190	4447700
3	4385390	4447700
4	4385521	4447594
5	4385580	4447646
6	4385532	4447724
7	4385657	4447813
8	4385986	4447613
9	4386336	4447141
Sip = 0.37 km²		

4384000

4385000

4386000

4387000

4388000

4447000

4446000

4445000